

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO Zyra për Propozime dhe Parashitresa - Kancelaria za Predloge i Preostavke - Table Office	
Nr. Prot. Ser. Prot. Prot. No: <u>07/435/L-006</u>	Data Datum Date: <u>09.07.2020</u>
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages: _____ PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E Kryeministrit - Ured Premijera - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARRIVE - ARCHIVE SECTOR	
Niveli Org. Org. Jedinica Org. Unit: <u>02/d/a</u>	Nr. Prot. Ser. Prot. Prot. No: <u>855/10</u>
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages: <u>- 70 -</u>	Data: Datum: Date: <u>09/07/2020</u>
Prishtinë 3	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - Secretary General

Datë, 9 korrik 2020
 Ref: 78/2020

Për: Z. Ismet KRASNIQI, Sekretar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Tema: Procedimi i materialit në Kuvend

I nderuar z. Sekretar,

Në përputhje me procedurën e parashikuar me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Rregulloren Nr.13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, nenin 53 pika 3 të Rregullorës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07-P-041 të datës 8 qershor 2020, paraqet mendim lidhur me Projektligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid - 19 në Territorin e Republikës së Kosovës.

Bashkëngjitur gjeni poashtu Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/12 të datës 9 korrik 2020.

Për informata dhe sqarime shtesë, si gjithnjë qëndrojmë në dispozicionin tuaj.

Me respekt,

Fitim Krasniqi
 Sekretar i Përgjithshëm



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/12

Datë: 09.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07-P-041 të datës 08.06.2020, jep mendim lidhur me nismën Legjislative për Projektligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID- 19 në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk e mbështet nismën legjislative nga pika 1 e këtij Vendimi.
3. Vendimi bashkë me tekstin e mendimit nga pika 1. e këtij vendimi i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Br. 02/12
Datum: 09.07.2020

Na osnovu člana 92. stav 4. i člana 93. stav (4) Ustava Republike Kosovo, na osnovu člana 4 Uredbe br. 06/2020 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava, izmenjene i dopunjene Uredbom br. 07/2020, u skladu sa članom 19 Poslovnika Vlade Republike Kosovo br. 09/2011, Vlada Republike Kosovo, na dužnosti, je na svojoj sednici održanoj 09. jula 2020. godine, donela sledeću:

ODLUKU

1. Vlada Republike Kosovo, u skladu sa Zaključkom Skupštinom Republike Kosovo br. 07-P-041 od 08.06.2020. Godine, daje mišljenje u vezi sa zakonodavnom inicijativom za Nacrt zakona o širenju i borbi protiv pandemije COVID-19 na teritoriji Republike Kosovo.
2. Vlada Republike Kosovo ne podržava zakonodavnu inicijativu iz tačke 1. ove odluke.
3. Odluka se, zajedno sa tekstom mišljenja iz tačke 1. ove odluke, dostavlja Skupštini Republike Kosovo.
4. Odluka stupa na snagu danom potpisivanja

Avdullah Hoti

Premijer Republike Kosovo

Dostavlja se:

- zamenicima Premijera
- svim ministarstvima (ministrima)
- generalnom sekretaru KPR-a
- Arhivi Vlade



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
 Ministry of Finance
 Arkiva - Arhiva - Archive

Nr. Jedin. Org. Unit: 06 Nr. Prot. Br. Prot. No.: 666-1
 Nr. i faqeve Broj stranica No. pages: 7 Data Datum Date: 07.07.20
 Dëftesa PRISHTINE/A

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Financave
 Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

Departamenti i Buxhetit - Budget Department - Budget Department

DATE	06.07.2020
REFERENCË	HR-90
PËR/ZATO:	z. Filim Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm i ZKM-së
CC:	z. Mentor Borovci, Drejtor i ZI-ZKM
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave
NGA/OD/FROM:	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinionimi i Departamentit të Buxhetit për ndikimin buxhetor të Projektligjit për Prandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID 19, në territorin e Republikës së Kosovës



I nderuar z. Krasniqi,

Zyra e Kryeministrit ka përcjellë në Ministrinë e Financave nismën legjislative të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Prandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid 19, në territorin e Republikës së Kosovës, formularin për vlerësimin e ndikimit buxhetor të përgatitur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, obligimin sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe nenin 19 të Ligjit Nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

Departamenti i Buxhetit të Kosovës, paraqet me sa vijon:

I. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKTLIGJIT

Projektligji për Prandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid 19, në territorin e Republikës së Kosovës, ka për qëllim të krijoj bazën ligjore për autoritetet shtetërore të Republikës së Kosovës, në rend të parë Ministrinë e Shëndetësisë (MSII) me qëllim të luftimit dhe parandalimit të pandemisë COVID 19, në territorin e Republikës së Kosovës, qoftë edhe përmes kufizimeve të domosdoshme të lirive dhe të drejtave të njeriut sipas nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.